

Pajisja e IAL-së me regjistrin themeltar të studentëve

Njoftojmë Institucionet e Arsimit të Lartë se kanë detyrimin ligjor që të mbajnë në formë të shkruar regjistrin themeltar të studentëve.

Procedura e aplikimit për pajisje me regjistrin themeltar të studentëve:

1. Për të tërhequr regjistrat themeltarë të studentëve, kërkohet nga ana juaj të dërgoni në QSHA kërkesën me shkrim, duke specifikuar emërtimin e saktë të programeve të studimit për të cilat kërkoni të pajisni me regjistra për regjistrimin e studentëve. Për secilin program studimi për të cilin kërkoni të pajisni me regjistër duhet të na dërgoni të dhënat lidhur me:

- Emërtimin e IAL-së (sipas aktit të hapjes);
- Emërtimin e Njësisë kryesore (sipas aktit të hapjes/riorganizimit, VKM, urdhër i Ministrit);
- Emërtimin e Programit të Studimit (sipas aktit të hapjes, riorganizimit);
- Lloji i Programit të Studimit (Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave etj);
- Forma e studimit (me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, në distancë).

Të dhënat e mësipërme plotësohen në kopertinën e secilit regjistër nga punonjësi i QSHA-së, prandaj duhet të dërgohen të dhëna të sakta.

2. Për secilin program studimi duhet të dërgoni aktin e hapjes dhe aktin e akreditimit të programit të studimit.

Tarifa e regjistrimit

Në VKM-në nr.560, datë 29.09.2018, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, parashikohet se tarifa për pajisjen e IAL-së me regjistrin themeltar të studentëve është 2 000 (dy mijë) lekë për regjistër, për llogari të QSHA-së sipas formularit të arkëtimit.